



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .12.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Implementimi i Smart Solution LoRaWAN ne infrastrukturen naftexjeresore te Albpetrol sh.a. per periudhe 2 vjecare”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 48614000-5 - Sistem i marrjes së të dhënave,

VLERA E FONDIT LIMIT: 78,804,667 (shtatëdhjetë e tetë milion e tetëqind e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 806,021 (tetëqind e gjashtë mijë e njëzet e një) Euro pa tvsh me kursin e kembimit te dates 30.12.2024

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashtrijmë arsyet kryesore për vendimin e mosndarjen në lote për këtë procedurë.

Objekti i prokurimit është konceptuar si një i tërë dhe për këtë arsye është e pamundur të ndahet në lote.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendorsja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

2.2.2. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit Nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohet të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

OSE

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet të mëparshme të

ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për pajisjet: Antenat (Gateway), sensorët inteligjentë të vëllimit dhe sensorët inteligjent të monitorimit të energjisë. Ky autorizim duhet të përfshijë kontaktet e plotë të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, si: numrin e telefonit, adresën e e-mailit dhe faqen e internetit. Në rast se autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të sigurohet vërtetimi i marrëdhënies midis tij dhe prodhuesit. Po ashtu, në deklaratën e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, duhet të konfirmohet se pajisjet e ofruara do të jenë të pajisura me sistemin origjinal të prodhuesit (OEM).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 40, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar garanton që pajisjet janë autentike dhe përmbushin standardet e kërkuara, duke shmangur rrezikun e përdorimit të pajisjeve të falsifikuara ose me cilësi të ulët. Kjo i siguron Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka mbështetje teknike të specializuar dhe të besueshme nga burime të autorizuar. Në rast problemesh teknike ose nevojë për përditësime, mbështetja nga prodhuesi ose distributori i autorizuar siguron një zgjidhje të shpejtë dhe profesionale. Për më tepër, ky kriter garanton furnizim të sigurt dhe mbështetje teknike të vazhdueshme gjatë periudhës së garancisë, duke siguruar që operatori ekonomik ka akses të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë në pajisjet e kërkuara dhe që furnizimet do të bëhen në mënyrë të besueshme dhe brenda afateve.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike në gjuhën shqipe ose angleze për produktet objekt prokurimi (antenat, sensorët inteligjentë të vëllimit dhe sensorët inteligjent të monitorimit të energjisë), ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (*shih specifikimet teknike*) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë sistemi/pajisja që ofrohen dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për to.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kriterin e kualifikimit për dorëzimin e katalogut/skedës teknike në gjuhën shqipe ose angleze nga operatori ekonomik, me qëllim që të sigurohet që produktet e propozuara janë të qarta dhe të krahasueshme me kërkesat teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit. Ky kriter garanton AK-s, që operatorët ekonomikë ofrojnë produkte që përputhen me specifikimet e kërkuara dhe shmang çdo paqartësi lidhur me cilësinë dhe performancën e pajisjeve. Markimi i produkteve dhe parametrave teknikë në katalogë bën më të lehtë dhe më të qartë procesin e vlerësimit, duke mundësuar vendimmarrje të bazuar në të dhëna të sakta teknike.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- b) Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- c) Standardin ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- d) Standardin ISO 45001:2018 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose ekuivalente, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme sipas standardit ISO.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Argumentimi 2.3.4/a: Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur dhe të paraqesë në sistemin elektronik të prokurimit Standardin ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë, pasi ky standard garanton që operatori ka një sistem të strukturuar dhe të certifikuar për menaxhimin efektiv të proceseve dhe cilësisë së shërbimeve që ofron. Ky kriter është thelbësor për të siguruar që produktet dhe shërbimet që ofrohen janë në përputhje me kërkesat e prokurimit kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, një certifikim i tillë i lëshuar nga një organ i akredituar ofron garanci për cilësinë dhe besueshmërinë e operatorit, duke minimizuar rrezikun e dështimeve dhe sigurimin e një vazhdimësie të qëndrueshme në projekt. Standardi ISO 9001:2015 promovon përmirësim të vazhdueshëm dhe është i njohur ndërkombëtarisht, duke rritur transparencën dhe sigurinë për përputhshmërinë e ofrimit të shërbimeve me nevojat dhe pritshmëritë e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi 2.3.4/b: Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalent, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, pasi ky standard ndërkombëtar garanton që operatorët ekonomikë kanë implementuar kontrole të sigurta dhe praktika të mira për menaxhimin e informacionit. ISO 27001:2022 siguron mbrojtjen e të dhënave sensitive, minimizon rreziqet e aksesit të paautorizuar, dhe garanton një qasje të strukturuar ndaj menaxhimit të sigurisë kibernetike. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin infrastrukturë kritike dhe të dhëna të ndjeshme, ky standard siguron që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin dhe kompetencat për të trajtuar

sfidat e sigurisë. Përcaktimi i këtij kriteri nga Autoriteti Kontraktor është jetik për të siguruar integritetin dhe besueshmërinë e sistemeve të përfshira në prokurim, duke përmirësuar në këtë mënyrë sigurinë e përgjithshme të informacionit dhe shmangien e incidenteve kibernetike.

Argumentimi 2.3.4/c: AK ka kërkuar që Operatori Ekonomik të paraqesë certifikimin ISO 20000-1:2018 për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, pasi ky standard është një garanci e cilësisë së ofrimit të shërbimeve në fushën e IT-së. Ky certifikim vërteton se Operatori Ekonomik ka zbatuar praktikën më të mirë në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve IT, përfshirë planifikimin, realizimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. Duke u bazuar në një standard ndërkombëtar të njohur, si ISO 20000-1:2018, Autoriteti Kontraktor sigurohet që shërbimet e teknologjisë së informacionit të ofruara nga O.E të jenë në përputhje me kërkesat e prokurimit, duke garantuar cilësi, efektivitet dhe përputhshmëri me standardet më të fundit të industrisë.

Argumentimi 2.3.4/d: Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën për paraqitjen e standardit ISO 45001:2018 ose ekuivalent, i cili është një standard ndërkombëtar për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (OSHMS), për të siguruar që operatorët ekonomikë që marrin pjesë në prokurim të garantojnë një nivel të lartë të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Duke pasur parasysh që projekti përfshin instalimin dhe konfigurimin e serverëve të rrjetit, antenave, sensorëve inteligjentë dhe pajisjeve për menaxhimin e energjisë, të gjitha këto procese përfshijnë veprime teknike që mund të kenë rreziqe për sigurinë e personelit dhe të mjedisit. Këto rreziqe mund të përfshijnë punën me pajisje të tensionit të lartë, rreziqet e lartësive për montimin e antenave, dhe ekspozimin ndaj kushteve të jashtme të punës, si dhe lëvizjen e pajisjeve të rënda dhe përpunimin e teknologjisë së ndërlikuar. Për më tepër, standardi siguron që operatori ekonomik ka politika dhe procedura të qëndrueshme për të minimizuar rreziqet gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e pajisjeve pas instalimit. Çertifikimi i standardit ISO 45001:2018 është një tregues i përgjegjësisë së operatorit ekonomik për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve të tij, si dhe një garanci për Autoritetin Kontraktor që standardet më të larta të sigurisë do të respektohen në çdo fazë të zbatimit të projektit.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit dhe vendosjes së pajisjeve hardware dhe software objekt-kontratë, duhet të disponojë minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjës, të diplomuar në një nga portelet e IT si, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për çertifikime profesionale, si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës të çertifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë
- b) 2 (dy) punonjës të çertifikuar në nivel experti në rrjeta dhe siguri
- c) 4 (katër) punonjës të çertifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete LoRaWAN, Cisco ose ekuivalente.
- d) 2 (dy) punonjës të çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.
- e) 1 (një) punonjës të çertifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa çertifikime.

Operatori Ekonomik i klasifikuar i pari, për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa më sipër, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentet në origjinal ose kopje të noterizuara për punonjësit e mësipërm, dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diplomë e arsimit të lartë, duke përfshirë të gjitha degët e informatikës, shkencave kompjuterike, dhe teknologjisë së informacionit.

- Certifikatat/Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituara nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjinës, për secilin specialist të kualifikuar.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit në të cilat stafi i sipërpermendur duhet të figurojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për instalimin, integrimin, konfigurimin dhe vendosjen në punë të sistemeve objekt-prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit është i nevojshëm për të provuar që është i diplomuar në një nga fushat e kërkuara dhe është në marrëdhënie pune pranë operatorit/ve ekonomikë ofertues. Këto janë dokumenta provuese që i shërbejnë Autoritetit Kontraktor që punonjësit e deklaruar nga operatori ekonomik disponojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e shërbimit.

Argumentimi 2.3.5/a): Kriteri i kualifikimit i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili kërkon një specialist të certifikuar në nivel profesional për projektimin me valë, i njohur si Certified Wireless Design Professional ose ekuivalent, është plotësisht në përputhje me kompleksitetin e teknologjisë së përfshirë në projektin objekt-kontratë për disa arsye të rëndësishme. Së pari, një specialist i certifikuar ka aftësitë e nevojshme për të dizajnuar dhe optimizuar rrjetet me valë që përfshijnë pajisje si antenat LoRaWAN, sensorët inteligjentë të vëllimit dhe pajisjet e menaxhimit të energjisë, të cilat komunikojnë përmes protokolleve si LoRaWAN. Këto pajisje kërkojnë një dizajn të kujdesshëm të rrjetit për të garantuar mbulimin e duhur, stabilitetin dhe besueshmërinë e komunikimit, veçanërisht kur kërkohet një rreze e madhe mbulimi prej deri në 15 km dhe mbështetja e deri në 10,000 pajisje fundore.

Së dyti, projektimi i një rrjeti me valë për këto pajisje kërkon ekspertizë specifike për të parandaluar interferencat dhe për të optimizuar cilësinë e sinjalit. Kjo përfshin menaxhimin e frekuencave dhe fuqisë së sinjalit për të siguruar një funksionim të qetë dhe të besueshëm të sistemit, duke garantuar që të dhënat të transmetohen dhe të merren pa ndërprerje.

Gjithashtu, përdorimi i teknologjive të sigurisë si enkriptimi AES-128 dhe mbrojtja e komunikimeve përmes protokollit TLS në rrjetet LoRaWAN kërkon një projektim të avancuar dhe një menaxhim të sigurt të të dhënave të ndjeshme. Specialist i certifikuar do mund të sigurojë që komunikimet të jenë të mbrojtura dhe në përputhje me standardet më të larta të sigurisë kibernetike. Së fundi, specialist i certifikuar do të sigurojë integrim efektiv të të gjitha pajisjet që përdorin komunikimin me valë – antenat, sensorët, pajisjet e menaxhimit të energjisë – me rrjetin ekzistues të Autoritetit Kontraktor dhe për të garantuar performancën e lartë të infrastrukturës objekt-kontrate.

Argumentimi 2.3.5/b dhe 2.3.5/c): Për shkak të kompleksitetit të projektit, është thelbësore që operatori ekonomik të ketë të punësuar te paktën 2 punonjes të certifikuar në nivel experti për rrjeta dhe siguri si dhe 4 specialistë të certifikuar në rrjet, si LoRa Alliance Certified Network Associate/Cisco Certified Network Associate/Cisco Certified Network Profesional ose ekuivalente, për të siguruar konfigurimin, sigurinë, mirëmbajtjen dhe menaxhimin efikas të rrjetit dhe pajisjeve të lidhura me projektin. Certifikimi i garanton AK-s që specialistë janë të trajnuar për të vendosur, konfiguruar dhe mirëmbajtur rrjete komplekse, siç kërkohet nga pajisjet si antenat LoRaWAN, serveri i rrjetit dhe platforma inteligjente, që përfshijnë lidhjet LAN, 3G/4G dhe konfigurime të rrjetit LoRaWAN.

Gjithashtu certifikimi i kërkuar dëshmon se specialistët janë të aftë për të menaxhuar arkitekturën me shtresa të sistemit të operimit të serverit, që ndan të dhënat dhe logjikën e biznesit, duke siguruar siguri dhe funksionalitet optimal. Specialistët e certifikuar kanë njohuri për menaxhimin e protokolleve të avancuara të sigurisë si TLS dhe për optimizimin e rrjeteve me trafik të lartë, duke siguruar që trafiku të jetë i rrjedhshëm dhe pa ndërprerje.

Argumentimi 2.3.5/d): Kërkesa e Autoritetit Kontraktor që Operatori Ekonomik të sigurojë dy punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë është kritike për garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemeve hardware dhe software gjatë periudhës së garancisë dhe mirëmbajtjes. Ky staf i kualifikuar do të sigurojë që sistemet e menaxhimit të rrjetit, si dhe pajisjet dedikuese dhe ato të rikuperimit kibernetik, të funksionojnë pa ndërprerje, duke u përballur në mënyrë efektive me çështje teknike të mundshme. Përveç kësaj, ata do të ofrojnë mbështetje teknike dhe asistencë për përdoruesit, ndërkohë që do të monitorojnë dhe optimizojnë performancën e sistemit në përputhje me nevojat në rritje. Kjo siguri shtesë për mbikëqyrjen e sistemeve do të kontribuojë në minimizimin e ndërprerjeve dhe në ruajtjen e një operacioni të qëndrueshëm.

Argumentimi 2.3.5/e): Për të menaxhuar një projekt me kompleksitet të lartë, që përfshin instalimin dhe konfigurimin e një infrastrukture teknologjike të avancuar, e cila përfshin pajisje si antenat LoRaWAN (gateway), sensorët inteligjentë, pajisjet për menaxhimin e energjisë dhe serverin e rrjetit, është thelbësore që projekti të drejtohet nga një profesionist me përvojë të avancuar në menaxhimin e projekteve teknologjike. Një menaxher projekti me certifikim në nivel profesional dëshmon aftësi të specializuara për të ndjekur një qasje metodike, e cila përfshin planifikimin e saktë të burimeve, menaxhimin e riskut, organizimin dhe koordinimin efektiv të ekipeve teknike, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të performancës së projektit. Këto aftësi sigurojnë që projektet komplekse të realizohen brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Kualifikimi profesional është gjithashtu një garanci për përdorimin e praktikave më të mira dhe aplikimin e metodologjive të menaxhimit të projekteve që mbështesin arritjen e qëllimeve strategjike dhe operacionale të projektit. Në një projekt të tillë kritik, ku siguria dhe përputhshmëria me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare janë thelbësore, një menaxher me përvojë do të garantojë implementimin e saktë të protokolleve të enkriptimit dhe të integritetit të teknologjive të reja. Ai do të luajë një rol kyç në koordinimin e komunikimit midis Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik, duke parandaluar problemet potenciale dhe duke siguruar që projekti të realizohet me cilësi të lartë.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku konfirmon se do të kryejë konfigurimin, implementimin dhe vënien në funksion të sistemeve dhe pajisjeve, si dhe të marrë përsipër trajnimin e përdoruesve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Konfigurimi, implementimi dhe trajnimi është i rëndësishëm për vënien në punë dhe funksionalitetin e sistemeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: